

Në bazë të nenit 16 paragrafi 1 pika 2 të Ligjit për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave ("Fleta zyrtare e Republikës së Malit të Zi", nr. 140/22), komisioni i regjistrimit në Komunën e Ulqinit, shpall

Thirrje Publike

Për angazhimin kontraktual të pjesëmarrësve për zbatimin e Regjistrimit të Popullsisë, Familjeve dhe Banesave, i cili do të mbahet nga data 1 – 15 nëntor 2023, përkatësisht:

INSTRUKTOR/E: 12 + 1 rezervë

KUSHTET E PËRGJITHSHME:

- Shtetas madhor i Malit të Zi;
- Nënshtetësia e Malit të Zi;
- Kualifikimi i nivelit arsimor VI, VII1, VII2 dhe VIII.

KUSHTE TË VEÇANTA:

- Të dinë të përdorin gjuhën e përdorur në zonën që po anketohet.

PËRPARËSI DO TË KENË KANDIDATËT QË PLOTËSOJNË EDHE DISA NGA KUSHTET E MËPOSHTME:

- -Vendbanimi në Komunën e Ulqinit, për të cilin aplikon (për shkak të njohjes së terrenit);
- -Të jetë i pa punësuar
- -Përvojë në realizimin e hulumtimeve statistikore;
- -Përvojë në kryerjen e trajnimeve, organizimin dhe koordinimin e aktiviteteve me një numër të madh njerëzish.

DOKUMENTAT TË CILËT DUHET TË BASHKANGJITEN:

- Aplikim për pjesëmarrësit në regjistrim (Formulari P-13);
- Një kopje të letërnjoftimit ose certifikatës së shtetësisë;
- Një kopje të diplomës ose certifikatës të nivelit dhe llojit të arsimit të përfunduar ose dëshmi se personi është student;
- Vërtetim nga Zyra e Punësimit të Malit të Zi që tregon se personi është i papunësuar ose vërtetim se personi është në pension;
- Dëshmi për përvojën në statistika, si dhe përvojën në mbajtjen e trajnimeve, organizimin dhe koordinimin e aktiviteteve me një numër të madh personash (kontratë pune/certifikatë/rekomandime).

ANKETUES TERRENI: 110 + 5 rezervë

KUSHTET E PËRGJITHSHME:

- Shtetas madhor i Malit të Zi;
- Nënshtetësia e Malit të Zi;
- Kualifikimi i arsimit të nivelit IV, V, VI, VII1, VII2 dhe VIII.

KUSHTE TË VEÇANTA:

- Të dinë të përdorin gjuhën e përdorur në zonën që po anketohet.

PËRPARËSI DO TË KENË KANDIDATËT QË PLOTËSOJNË EDHE DISA NGA KUSHTET E MËPOSHTME:

- Vendbanimi në Komunën e Ulqinit, për të cilin aplikon (për shkak të njohjes së terrenit);
- Të jetë i pa punësuar;
- Përvojë në realizimin e hulumtimeve statistikore;

DOKUMENTAT TË CILËT DUHET TË BASHKANGJITEN:

- Aplikim për pjesëmarrësit në regjistrim (Formulari P-13);
- Një kopje të letërnjoftimit ose certifikatës së shtetësisë;
- Një kopje të diplomës ose certifikatës të nivelit dhe llojit të arsimit të përfunduar ose dëshmi se personi është student;
- Vërtetim nga Zyra e Punësimit të Malit të Zi që tregon se personi është i papunësuar ose vërtetim se personi është në pension;
- Dëshmi për përvojën në statistikora (kontratë pune/certifikatë/rekomandime).

Kandidati mund të aplikojë ose si instruktor ose si anketues terreni.

Kandidatët mund të marrin formën e aplikimit për pjesëmarrës në regjistrim në ambientet e komisionit të regjistrimit Komuna e Ulqinit, Zyra e qytetarëve (BIRO), Bulevar Gjergj Kastrioti Skenderbeu pn., Ulqin duke filluar nga 22 shtatori dhe duke përfunduar më 1 tetor 2023 nga ora 08:00 deri në orën 15:00; ose ta shkarkojnë atë nga faqja e internetit e Aministratës të Statistikave: www.monstat.org

Forma e aplikimit e plotësuar për pjesëmarrësit në regjistrim dhe dokumentacioni i plotë mund të dorëzohen personalisht ose me postë brenda 10 ditëve në një periudhë të caktuar kohore, në zarf të mbyllur çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në 15:00, në adresën e komisionit të regjistrimit.



Në zarf duhet të shkruhet emri i vendit për të cilin po aplikoni (instruktur/e ose anketues/e) dhe adresa e komisionit të regjistrimit: Komisioni i regjistrimit, Komuna e Ulqinit.

Të gjithë kandidatët duhet të nënshkruajnë një deklaratë (të dhënë në aplikimin për pjesëmarrësit e regjistrimit) që gjatë periudhës së trajnimeve (23 - 25 tetor 2023 dhe 28 - 29 tetor 2023) si dhe periudhës së regjistrimit (1 - 15 . Nëntor 2023) do të jetë në dispozicion për aktivitetet e regjistrimit.

Lista e kandidatëve për instrukturë do të publikohet më 11 tetor 2023, ndërsa lista e kandidatëve për anketues do të publikohet më 16 tetor 2023 në zyrën e komisionit të regjistrimit.

Per informacione shtese ne numrin e telefonit: 030412050.